



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA

Titulli i temës:

**“Shqiptimi i masave alternative në territorin e gjykatës themelore Dibër në
periudhën prej vitit 2008 deri 2018”**

Mentori:

Prof. Dr. Ismail Zejneli

Kandidati:

Arbër Dika

Tetovë, 2020

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
- Metodologjia e hulumtimit.....	6
- Hipotezat.....	7
- Arsyeshmëria e punimit.....	7
KAPITULLI 7	7
1. Nocioni i masave alternative.....	8
2. Zhvillimi historik i masave alternative	8
3. Qëllimi i masave alternative	9
4. Aspektet krahasuese të masave alternative	10
4.1. Aspektet krahasimore me Republikën e Shqipërisë.....	10
4.1.1. Gjysmëliria.....	10
4.1.2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në prove.....	11
4.1.3. Qëndrimi në shtëpi.....	11
4.1.4. Detyrimet e të dënuarit të vënë në prove	12
4.1.5. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik.....	12
4.2. Aspektet krahasimore me Republikën e Kosovës.....	13
4.2.1. Dënimi me kusht.....	13
4.2.2. Gjysmëliria.....	14
4.2.3. Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues	14
4.2.4. Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.....	15
4.2.5. Dënimi me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme	15
5. Aspektet krahasuese të masave alternative të parashikuara në Republikën e Shqipërisë dhe Kosovës me atë të Maqedonisë së Veriut	16
KAPITULLI II	20
1. Faktorët objektiv	20
1.1.1. Faktorët ekonomik-shoqërore	21
1.1.2. Industrializimi, urbanizimi dhe kriminaliteti	21
1.1.3. Migrimi i njerëzve dhe kriminaliteti i të huajve.....	21
1.1.4. Faktorët ideopolitike të kriminalitetit.....	22

1.2.	Krizat, depresionet ekonomike dhe kriminaliteti	22
1.3.	Varfëria dhe kriminaliteti.....	22
1.4.	Papunësia dhe kriminaliteti.....	23
1.5.	Kushtet e vështira të banimit dhe kriminaliteti	23
1.6.	Profesioni-mjeshtri dhe kriminaliteti	23
2.	Faktorët subjektiv.....	24
2.1.	Karakterit dhe kriminaliteti	24
2.2.	Temperamenti dhe kriminaliteti.....	25
2.2.1.	Temperamenti kolerik.....	25
2.2.2.	Temperamenti sanguinik.....	25
2.2.3.	Temperamenti flegmatik	26
KAPITULLI III		27
1.	Masat alternative në Kodin Penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut (KPMV)	27
2.	Llojet e masave alternative	28
3.	Dënimi me kusht	32
3.1.	Nocioni dhe sistemi i dënimit me kusht.....	32
3.2.	Dënimi me kusht sipas KPMV.....	32
4.	Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse	33
4.1.	Ndërpreja me kusht e procedurës penale	34
5.	Puna në dobi të përgjithshme	35
5.1.	Nocioni dhe natyra juridike.....	35
5.2.	Kushtet ligjore për shqiptim sipas KPM	35
6.	Vërejtja gjyqësore	35
6.1.	Nocioni dhe natyra juridike.....	35
6.2.	Kushtet ligjore për shqiptim.....	36
7.	Burgu shtëpiak	36
7.1.	Nocioni dhe natyra juridike.....	36
7.2.	Kushtet ligjore të KPMV	37
KAPITULLI IV		37
1.	Shqiptimi i dënimeve alternative në gjykatën themelore në Dibër	37
2.	Raste studimore-hulumtuese	41
3.	Caktimi i dënimit	45

4. Ekzekutimi i masave alternative	51
KONKLuzionet	53
Bibliography	56
Shtojca.....	58
Kopje e disa rasteve të studimit të dënimeve alternative në Gjykatën themelore Dibër	58

Hyrje

Masat alternative e tregojnë idenë themelore mbi të cilën është koncentruar reforma bashkëkohore dhe sistemi i sanksioneve. Kjo tendencë gjen mbështetje dhe arsytim si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Ajo është më shumë se përgjigje gjatë krizave të shpeshta nëpër burgje duke shërbyer si hyrje në shfrytëzimin e metodave dhe teknikave të reja të kontrollit social të kriminalitetit, që janë në hap me teknologjinë e informatikës.

Ky proces i cili fitoi përkrahje të fortë bashkëkohorë, posaçërisht nëpërmjet aktiviteteve të OKB-së: statumi në sistemin e sanksioneve të alternativave të pranueshme është preokupim i vazhdueshëm i disa kongreseve për preventivën e krimit dhe trajtimin e shkelësve të ligjit në rangun global.

Rregullat e Tokios, të miratuara me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në vitin 1990, përmbajnë sistem të normave dhe standardeve të themeluara mbi qëndrimet se dënimi paraqet mjet të fundit dhe se duhet të stimulohen masat joburgosëse që sigurojnë ekuilibër mes të drejtës së kryerësit, të drejtës së viktimës dhe interesit të shoqërisë. Masat të cilat do t'i shtjellojmë më gjerë siç janë: masat paragjyqësore, masat që i ndërmer policia ose prokuroria, alternativat e paraburgimit, alternativat gjyqësore të dënimit, dënimi me kusht, dënimi me kusht në mbikëqyrje mbrojtëse, puna në dobi të përgjithshme, burgu shtëpiak dhe vërejtja gjyqësore, si dhe alternativat post gjyqësore të burgut siç është burgu gjysmëditor, lirimi me kusht, etj.

Në këtë punim, fokusi i hulumtimit tonë është pikërisht analiza e zbatimit të masave alternative në kontekstin lokal, e në rastin konkret në Gjykatën themelore në Dibër. Për të shtjelluar në mënyrë shkencore këtë fenomen të rëndësishëm në sistemin e dënimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të zbatuar në raste konkrete studimi, së pari kemi bërë analizën krahasuese të sistemit të dënimeve me masa alternative me Republikën e Shqipërisë dhe atë të Kosovës. Pas këtij krahasimi pason analiza shkencore e faktorëve që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit, që janë të rëndësishme gjatë përcaktimit të masës me dënimin alternativ. Kemi përpunuar faktorët objektiv dhe ata subjektiv në veçanti.

Të gjithë këto analiza janë sintetizuar me përshkrimin e detajuar të masave alternative në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për të vlerësuar shqiptimin e dënimeve me masa alternative në praktikë, kemi përpunuar të dhënat nga enti shtetëror i statistikës për disa gjykata themelore që gravitojnë përreth rajonit të Dibrës dhe janë vendosur në rrafshin krahasues me dënimet e alternative të shqiptuara në Gjykatën themelore të Dibrës, të gjitha këto për periudhën dhjetëvjeçare - nga viti 2008 deri në vitin 2018. Duke u ndeshur edhe me të dhëna jo të mjaftueshme statistikore, për të ruajtur argumentimin relevant shkencor, kemi përdorur raste studimi të masave të shqiptuara alternative nga arkiva e gjyqit.

Për të shpalosur konkluzat, të gjithë analizat dhe krahasimet janë paraqitur në formë tabelare, ndërsa për të nxjerrë trendet e zhvillimit të shqiptimit të masave alternative është përdorur metoda grafike e prezantimit. Të gjithë këto të dhëna, të integruara me rastet studimore dhe analizën në arkivin e Gjykatës themelore në Dibër, kemi arritur të nxjerrim përfundime të vlefshme për praktikën e zbatimit të masave alternative si dhe të propozojmë edhe qasje për përmirësimin e tyre.

- Metodologjia e hulumtimit

Gjatë hulumtimit të objektit të studimit janë përdorur metoda e analizës dhe sintezës, që na kanë ndihmuar të arrijmë objektivat e kërkimit. Metoda e analizës është përdorur gjerësisht si në analizën e Kodeve të vendeve të ndryshme, në këtë rast me fokus në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës, si dhe atë të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke u fokusuar edhe në praktikën gjyqësore, me qëllim nxjerrjen në pah të problemeve që ekzistojnë, mangësitë si dhe kundërshtimet e dispozitave ligjore.

Në këtë punim kemi përdorur Metodën historike, Metodën juridike, Metodën krahasuese dhe Metodën statistikore.

Në punimin e kësaj teme do të shfrytëzohen të dhënat e gjykatave, të entit statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe burimet e tjera zyrtare.

- Hipotezat

Gjatë këtij hulumtimi shkencor do të paraqesim disa hipoteza, të cilat gjatë përpunimit të tezës do të vërtetohen.

Hipoteza 1. Gjatë caktimit të dënimeve shpeshherë shqiptohen dënimet alternative.

Hipoteza 2. Në dënimin me masa alternative paraqiten edhe obligimet plotësuese.

Hipoteza 3. Të shqyrtohen kushtet ligjore për shqiptimin e masës punë në dobi të përgjithshme që të përdoret kjo masë në nivelin e duhur.

- Arsyeshmëria e punimit

Zbatimi i alternativave tradicionale të burgut (dënimi me të holla, dënim me kusht) në dekadat e fundit të shekullit të kaluar nuk ndihmuan shumë në reduktimin e tij. Për këtë sot në shumë legjislacione perëndimore ka filluar trendi i gjetjes së masave të reja alternative.

Ky proces i cili fitoi përkrahje të fortë bashkëkohore, posaçërisht nëpërmjet aktiviteteve të OKB-së: statumi në sistemin e sanksioneve të alternativave të pranueshme është preokupim i vazhdueshëm i disa kongreseve për preventivën e krimit dhe trajtimin e shkelësve të ligjeve.

Me ndryshimet në sistemin penal në dekadat e fundit padyshim ka filluar transformim i madh i dënimit, që do të thotë deinstitutionalizim, largim nga sistemi i burgut dhe zbatim i formave të tjera të kontrollit social mbi kriminelët.

KAPITULLII

1. Nocioni i masave alternative

Nocioni i masave alternative në rrethin juridik evropian është shumë i gjerë dhe përfshin sanksione të ndryshme dhe procedura që mund të zbatohen në cilën do fazë te procedurës: alternativat e procedurës penale, alternativat e gjykimit, alternativat e burgut.

Disa autorë flasin për alternativat joburgosëse në vend të sanksioneve alternative, sepse nocioni i fundit e implikon qëndrimin se dënimi me burg është rregull, ndërsa të gjithë masat tjera janë sekondare (Kambovski & Zejneli, E drejta penale - Pjesa e përgjithëshme, 2018)¹.

Për dallim nga ky nocion i ngushtë i alternativave gjyqësore i koncentruar në sanksionet alternative që i përfshinë të gjitha fazat dhe procedurat (Saiti, 2016)². Të tilla janë: masat për shmangie të paraburgimit , në të drejtën e procedurës sonë penale p.sh. garancitë, premtimet e të akuzuarit se nuk do ta lëshojë vendqëndrimin, si dhe masat që mund të shfrytëzohen për shmangien të zbatimit të dënimit në procedurë para shqiptimit të sanksionit.

Nocioni ekstensiv i alternativave e karakterizon tendencën e lëvizjes në të majtë të kompetencave të organeve që marrin pjesë në procedurë prej gjykatës deri te prokuroria publike dhe policia , zbatimi i masave në të cilat zgjidhet rasti kriminal pa dënim dhe gjykim.

2. Zhvillimi historik i masave alternative

Deri në fund të shekullit XIX dënimet kryesore kanë qenë i vetmi lloj i sanksioneve penale që në të drejtën penale kanë mundur të shqiptohen ndaj kryesve të veprave penale. Dënimi me kusht që sipas legjislacionit të Republikës së RM-së bën pjesë në kapitullin e dënimeve alternative si lloj i posaçëm i sanksionit penal është paraqitur në shekullin XIX si rezultat i njohurive se një numër i personave që i kanë dënuar gjykatat, kanë kryer vepra penale pak të rrezikshme dhe si persona që kanë kryer vepra penale për herë të parë. Dënimi me kusht për herë të parë është paraqitur në SHBA dhe Angli me emrin “probation” – Sprovim (Dr.

¹ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale - Pjesa e përgjithëshme, Shkup, 2018, faqe 295.

² Xhemail Saiti, Нормативни и практични претпоставки за примена на алтернативните мерки, Shkup 2016 (<http://journal.maclc.mk/wp-content/uploads/2017/05/Dzemali-Saiti.pdf>)

Salihu, 1995)³. Në legjislacionet penale janë të njohur tri sisteme të dënimit më kusht: Sistemi anglo-amerikan apo i sprovimit. Si karakteristikë e këtij sistemi është se ndaj kryesit të veprës penale zhvillohet procedura penale, konstatohet fajësia e tij, mirëpo nuk i shqiptohet dënimi. Personi i tillë gjatë pezullimit të shqiptimit të dënimit vihet nën mbikëqyrjen e posaçme të cilën e ushtron personi zyrtarë i emëruar nga ana e gjyqit. Sistemi evropian kontinental, karakteristikë e këtij sistemi të dënimit me kusht është se kryesin e veprës penale gjyqi e shpall fajtor dhe ia shqipton dënimin, mirëpo dënimin e shqiptuar nuk e ekzekuton, këtë e pezullon për një kohë të caktuar, me kusht që kryesi gjatë kësaj kohe të mos kryej vepër të re penale dhe t'i përmbushë kushtet e tjera që gjyqi mund t'ia caktoj me aktgjykim. Në këtë sistem nuk caktohet personi zyrtarë për përcjellje, mirëpo në rast të mos respektimit të tij mund të zëvendësohet me ndonjë dënim tjetër më të ashpër nga ana e gjykatës. Sistemi i përzier i cili përmban elemente si të sistemit kontinental ashtu edhe të atij anglo-amerikan. Sipas këtij sistemi ndaj kryesit të veprës penale zhvillohet procedura penale, i shqiptohet dënimi dhe pezullohet ekzekutimi i tij, por gjykata mund ti caktoj edhe masë të posaçme të mbikëqyrjes për një kohë të caktuar.

3. Qëllimi i masave alternative

Qëllimi kryesor i këtij punimi hulumtues është njohja dhe studimi i masave alternative, si; dënimi me kusht; dënimi me kusht nën mbikëqyrjen e shtuar, puna në dobi të përgjithshme etj.

Parashikimi i dënimeve dhe masave alternative si zëvendësimi i dënimit me burgim, është trend progresiv në të drejtën penale bashkëkohore dhe njëherë paraqet formë të rëndësishme në konceptin e sistemit të sanksioneve ndëshkuese (PAKTIS, 2014)⁴. Është i pamohueshëm roli i penologjisë, si shkencë e cila merret me ekzekutimin e sanksioneve penale por edhe si shkencë që merret me trajtimin dhe studimin edhe të disa sanksioneve tjera, si p.sh.

³ Dr. Ismet Salihu "E Drejta Penale -Pjesa e përgjithshme", Prishtinë, 1995, fq 366.

⁴ Shoqata Qendra për strategji dhe zhvillim PAKTIS, Систем на алтернативни мерки со посебен осврт на состојбата на имплементација во општина Прилеп, 2014, fq. 9.

http://www.pactismk.com/pdf/EPI_Pactis_Brosura.pdf.

dënimet alternative, të cilat për një kategori të shkelësve të ligjit janë më efikase dhe me to arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, e i cili është gjithësisht risocializim. Është i pamohueshëm roli i penologjisë, si shkencë e cila merret me ekzekutimin e sanksioneve penale por edhe si shkencë që merret me trajtimin dhe studimin edhe të disa sanksioneve tjera si p.sh. dënimet alternative, të cilat për një kategori të shkelësve të ligjit janë më efikase dhe me to arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, e i cili është gjithësisht risocializimi dhe jo dënimi si qëllim në vetvete.

4. Aspektet krahasuese të masave alternative

Në këtë nënkapitull do të shqyrtojmë aspektet kryesore krahasuese të masave alternative me Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës.

4.1. Aspektet krahasimore me Republikën e Shqipërisë

Masat alternative qëi parasheh kodi penal i Shqipërisë janë: gjysmëliria, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, qëndrimi në shtëpi, detyrimet e të dënuarit të vënë në provë, detyrimi për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës, detyrimet e të dënuarit gjatë kohës së provës, shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik, lirimi me kusht, periudha e sigurisë (Kodi penal i Republikës së Shqipërisë)⁵. Po i shtjellojmë disa, si në vijim.

4.1.1. Gjysmëliria

Për dënimin deri në një vit burgim, gjykata, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri. Personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmëliri, është i detyruar të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata. Kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimet.

⁵ Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, nenet 58-65/a, 1995.

4.1.2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë

Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.

4.1.3. Qëndrimi në shtëpi

Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.
- b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.
- c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.
- ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paaftë nga ana shëndetësore.
- d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësive familjare (Ukaj, 2006)⁶.

Kushtet e vendosura në lidhje me qëndrimin në shtëpi, si formë alternative e dënimit, janë konform praktikave ndërkombëtare për këtë lloj dënimi dhe autorët në veçanti

⁶ Bajram Ukaj, Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006, faqe 206.

specifikojnë kushtet për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë, duke inkorporuar edhe baballarët që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijët, si dhe për personat me kushte të rënda shëndetësore dhe ata me paaftësi nga aspekti shëndetësor.

4.1.4. Detyrimet e të dënuarit të vënë në prove

I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtme⁷: Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional. Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare. Të riparojë dëmin civil të shkaktuar. Të ndalohej të drejtojë automjete të caktuara. Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari. Të mos frekuentojë vende të caktuara. Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike. Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara. Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale. Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë. Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues. Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës. Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivet e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethanat të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikëqyrjen e tyre.

4.1.5. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik

Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të

⁷ Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, neni 60, 1995.

përbushë një punë në interes publik. Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë. Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancë gjyqësore. Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh. Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë. Pas përfundimit të punës, dënimi konsiderohet i paqenë⁸. Nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën.

4.2. Aspektet krahasimore me Republikën e Kosovës

Masat alternative në Republikën e Kosovës janë: Dënimi me kusht, Gjysmë liria, Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues, Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, Dënimi me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme (Kodi penal i Republikës së Kosovës)⁹.

4.2.1. Dënimi me kusht

Dënimi me kusht është pezullim i ekzekutimit të dënimit të shqiptuar për një kohë të caktuar dhe me kushtet e caktuara. Qëllimi i dënimit me kusht është që kryesit t'i jepet qortimi, i cili e arrin qëllimin e dënimit përmes shpalljes së dënimit pa ekzekutimin e dënimit, dhe përmes kësaj të arrihet risocializimi i delikuentet. Dënimi me kusht është paraparë në nenin 48 të Kodit Penal të Kosovës, ndërsa kushtet që duhet të përmbushen që të shqiptohet janë paraparë në dispozitën 49 të Kodit. Sipas kësaj dispozite në grupin e parë të kushteve të cilat duhet të

⁸ Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, neni 63, 1995.

⁹ Kodi penal i Republikës së Kosovës (nr.06/L-074), nenet 46-58, Prishtinë, 2019.

përbushen që të shqiptohet dënimi me kusht, janë kushtet që i referohen dënimit të paraparë me ligj dhe dënimit të shqiptuar nga ana e gjykatës, dhe në grupin e dytë bëjnë pjesë kushtet të cilat i referohen personalitetit të kryesit të veprës penale dhe qëllimit të dënimit me kusht. Po ashtu, që të mund të shqiptohet dënimi me kusht KPK ka paraparë që duhet që duhet të përbushen edhe kushtet që i referohen personalitetit të kryesit, sikurse që janë sjellja e mëparshme, sjellja e kryesit pas kryerjes së veprës penale, shkalla e përgjegjësisë penale, rrethanat tjera në të cilat është kryer vepra penale.

4.2.2. Gjysmëliria

Gjysmë liria është lloji i pestë i dënimit alternative i para parë me kodin penal të Kosovës¹⁰. Gjysmë liria si lloj i dënimit alternative konsiston në atë që personit që i është shqiptuar dënimi me burgim i mundësohet çdo ditë brenda orëve të caktuara (6, 8 apo 10 orë) të mund të qëndroj në liri për të vazhduar punën profesionale të cilën e ka kryer edhe para kryerjes së veprës penale, të kryej punë familjare, apo punë tjera të cilat vlerëson gjykata. Si kusht për t'iu shqiptuar gjysmë liria si dënim alternativ, sipas nenit 58 të KPK-së është që gjykata të shqiptojë dënim me burgim deri një vit, dhe pastaj të urdhërojë ekzekutimin e dënimit në gjysmë liri për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional ose të arsyeve tjera të cilat i vlerëson gjykata. Programin për implementimin e dënimit në gjysmë liri e përpilon drejtori i burgut në bashkëpunim me organin e shërbimit sprovues.

4.2.3. Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues

Gjykata mund ti shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga dhe alkooli, nëse gjykata konstaton se faktori kryesorë që ka ndikuar në kryerjen e veprës penale është alkooli ose droga dhe se trajtimi i suksesshëm do të zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues. Program i trajtimit mbikëqyret nga shërbimi sprovues. Dënimi konsiderohet se është mbajtur me kryerjen e suksesshme të programit të trajnimit rehabilitues. Nëse personi i dënuar largohet nga

¹⁰ Kodi penal i Republikës së Kosovës (nr.06/L-074), neni 58, Prishtinë, 2019.

program i trajtimit rehabilitues apo nuk i përmbushë detyrimet lidhur me urdhrin për trajtim, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, mund ta shtyjë kohëzgjatjen e urdhrin për trajtim ose të revokojë dënimin me kusht dhe të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënim me kusht (Salihu, E drejta penale e përgjithshme, 2015)¹¹.

4.2.4. Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues

Gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht me urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, nëse konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues pas shqyrtimit të dosjes së shërbimit sprovues.

Me rastin e zgjedhjes midis detyrimeve të parapara me nenin 55 të KPK¹², gjykata merr parasysh në veçanti moshën e personit të dënuar, gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore dhe mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën, motivet që e kanë shtyrë të kryej veprën penale, sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale, sjelljet e tij në të kaluarën, rrethanat e tij të tjera personale dhe ato në lidhje me familjen që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit të mbikëqyrjes dhe kohëzgjatjes së saj. Nëse personi i dënuar nuk mbanë kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbushë detyrimin e paraparë, siç është caktuar nga gjykata, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht.

4.2.5. Dënimi me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme

Pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues gjykata mund t'ia shqiptojë kryesit dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme të paraparë në paragrafin 1 të nenit 57 të KPK-së, nëse gjykata e shpall dënimin me gjobë deri në 2.500 euro ose me burgim deri në një vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar. Nëse e shqipton dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme,

¹¹ Ismet Salihu, E drejta penale e përgjithshme, Prishtinë, 2015, faqe 241.

¹² Kodi penal i Republikës së Kosovës (nr.06/L-074), neni 55, Prishtinë, 2019.

gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryej pa pagesë punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej 30 deri 240 orë pune. Shërbimi sprovues vendosë për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet të kryhet nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryej punë në dobi të përgjithshme, vendosë për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme do të kryhet dhe mbikëqyrë kryerjen e punëve në dobi të përgjithshme. Nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, nuk mbanë kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e kryen detyrimin nga neni 57 i KPK-së siç janë mjekimi ose rehabilitimi mjekësorë, nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësorë ose të rehabilitimit etj., të cilat i kemi përmendur më lartë (Salihu, E drejta penale - pjesa e përgjithshme, 2015)¹³.

Për të trajtuar aspektin krahasimor të trajtimit të masave alternative të dënimit, të parapara në kodet penale të përshkruara më lartë – atë të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, në seksionin 5 në vazhdim, do ti paraqesim ato të krahasuara me disa aspekte të masave alternative në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe do ti komentojmë të njëjtat.

5. Aspektet krahasuese të masave alternative të parashikuara në Republikën e Shqipërisë dhe Kosovës me atë të Maqedonisë së Veriut

Shtjellimet për masat krahasuese dhe trajtimin e tyre sipas Kodeve penale përkatëse – atë të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, të shpjeguara në seksionin 4.1 dhe 4.2, do ti vendosim në një tabelë krahasuese (Tabela 1) me masat alternative të trajtuara në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut ¹⁴.

Në këtë tabelë krahasuese, janë përshkruar të gjithë dënimet alternative sipas Kodeve penale gjegjëse dhe, për qëllime të përcaktuara në këtë punim, atë të krahasimit të dënimeve

¹³ Ismet Salihu, E drejta penale – pjesa e përgjithshme, 2015, Prishtinë, faqe 253.

¹⁴ Kodi Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 37/96). Ligjet për Ndryshimet në Kodin Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "Nr. 80/99, 4/02, 43/03, 19/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013). Teksti I spastruar i shpallur nga Prokuroria publike e Republikës së Maqedonisë (<http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/законик-пречистен-текст.pdf>).

alternative në të tre shtetet e përmendura: Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Në mënyrë të veçantë jemi fokusuar në kushtet e përcaktuara në secilin kod penal, sipas llojit të masës alternative dhe kjo qasje na ka mundësuar të fitojmë një pasqyrë të qartë të krahasimit të kushteve specifike.

Tabela1. Krahasimi I masave alternative

Lloji i dënimit alternativ	Kodi penal i Republikës së Shqipërisë	Kodi penal i Republikës së Kosovës	Kodi penal i Maqedonisë së Veriut
Dënimi me kusht	Për dënime me burgim deri në 5 vjet.	Për dënime me burgim deri në 5 vjet.	Për dënime me burgim deri në 2 vjet burg.
		Për dënime me burgim deri në 10 vjet, me zbatim të dispozitës për zbutje të dënimit.	Për dënim me gjobë.
Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse	Është vendosur provë prej 18 deri në 5 vjet. Në mënyrë të veçantë (Neni 60/a) është paraparë detyrimi për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit dhe drogës.	Kohëzgjatja e kushtit me mbikëqyrje nuk mund të jetë më pak se 6 muaj e jo më shumë se 3 vjet. Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues është trajtuar në mënyrë të veçantë (Neni 54).	Koha e mbikëqyrjes me kusht përcaktohet nga gjykata.
Puna në dobi të përgjithshme	Për dënime deri në 1 vjet burg.	Për dënime deri në 1 vjet burg ose dënim me gjobë deri në 2.500 Euro.	Për vepra penale me dënim deri në 3 vite burg ose dënim me gjobë.
	Dënim prej 40 deri në 240 orë pune. Puna në interes publik mund të kryhet brenda afatit prej 6 muajve.	Dënim prej 30 deri në 240 orë pune.	Dënim prej 40 deri në 240 orë pune, e jo më pak se 5 orë në javë.
Vërejtja	Nuk ka të parashikuar.	Nuk ka të parashikuar.	Për vepra penale me dënim deri në 1 vit burg

gjyqësore			ose dënim me gjobë.
Burgu shtëpiak	Për dënimet me burgim deri në 2 vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit.	Nuk ka të parashikuar. Përmendet vetëm arresti shtëpiak, periudhë e cila llogaritet në dënimin e shqiptuar.	Për vepra penale me dënim deri në 1 vit burg ose dënim me gjobë.
Gjysmë liria	Për vepra penale me dënim deri në 1 vit burg.	Për vepra penale me dënim deri në 1 vit burg.	Nuk është e paraparë.

Nga tabela mund të nxirren lehtësisht konkluzat krahasimore, si vijon:

- Për dënimin me kusht:

Në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë, në nenin 50, paragrafi 1, është paraparë dënimi me kusht si masë alternative, për dënime të veprave penale me kohëzgjatje deri në 2 vite burg. Sipas tabelës, shihet se në Republikën e Maqedonisë, dënimi me kusht si masë alternative, është më konservativ, apo më rigoroz në krahasim me kushtet e parapara në Kodin penal të Republikës së Shqipërisë dhe atë të Kosovës. Atje, në nenin 59, paragrafi 1 për Kodin penal të Republikës së Shqipërisë, është paraparë masë e ngjashme alternative për dënime deri në 5 vjet burgim; ndërsa në Republikën e Kosovës, në nenin 49, paragrafi 1, është paraparë dënimi me kusht për vepra penale me dënim deri në 5 vjet burg, ose, nëse zbatohet masa e zbutjes së dënimit (paragrafi 2), mund të vlejë edhe për dënime deri në 10 vjet burg. Pra në të dy rastet, Kodi penal i shteteve fqinje parasheh kushte me të favorshme për shqiptimin e këtij dënimi alternativ dhe që do të ishte një çështje që duhet të merret parasysh në fazat e ardhshme të diskutimit të dënimeve alternative në Maqedoninë e Veriut.

- Për dënimin me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse:

Edhe ky lloj i dënimit alternativ është i paraparë nga Kodet penale të të tre shteteve të analizuara në tabelën krahasimore. Përderisa në Kodin penal të Republikës së Shqipërisë (neni 59, paragrafi 3) dhe atë të Kosovës (neni 55, paragrafi 2) janë paraparë afate të kohëzgjatjes së dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse – 18 muaj deri 5 vjet dhe 5 vjet, respektivisht, në

Maqedoninë e Veriut nuk është paraparë një kohëzgjatje e tillë, por i është lënë vetë gjykatës të përcaktojnë kohëzgjatjen e kësaj mase, e paraparë në nenin 55, paragrafi 2. Vlerësoj që kjo qasje është më e plotë, mbasi i jep mundësisë gjykatës që të analizojë kushtet individuale dhe në bazë të kushteve të përcaktojë edhe kohëzgjatjen relevante sipas rastit në shqyrtim. Një mangësi, sipas vështrimit tim, në Kodin penal të Maqedonisë së Veriut është edhe mos-përshkrimi më i detajuar i kushteve të kësaj mase alternative për kategorinë e përdoruesve të drogës dhe alkoolit dhe mundësia e rehabilitimit të tyre. Në Kodet penale të Republikës së Shqipërisë (neni 60/a) dhe atij të Kosovës (neni 54) janë parapara kushtet specifike për këtë kategori të dënuarish si dhe mënyra dhe kushtet e rehabilitimit eventual. Do të sygjeroja që gjithashtu, edhe në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut të ndiqet kjo praktikë për këtë kategori të të dënuarve, duke i trajtuar në mënyrë specifike dhe për të parashikuar kushtet e rehabilitimit të mundshëm nga këto 'sëmundje moderne'.

- Për punën në dobi të përgjithshme:

Masa alternative e dënimit me punë në dobi të përgjithshme, apo siç quhet më ndryshe në Kodin penal të Republikës së Shqipërisë – kryerja e një pune në interes publik, është e paraparë në të tre shtetet. Përderisa kushtet e kryerjes së punës në dobi të përgjithshme janë paraparë ngjashëm në të tre shtetet (diku prej 30 deri në 240 orë pune), në Kodin penal të Maqedonisë së Veriut – neni 58-6, ky dënim është më i butë dhe mund të shqiptohet për dënime deri në 3 vjet, ndërsa në Shqipëri dhe Kosovë është i paraparë vetëm për dënime deri në 1 vjet burg. Në Maqedoni dhe Kosovë, ky dënim mund të shqiptohet edhe për të dënuarit me dënim me gjobë dhe që përbën një praktikë pozitive.

- Për vërejtjen gjyqësore:

Nga Tabela 1 mund të shihet qartë se dënimi alternativ me vërejtje gjyqësore është i paraparë vetëm në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut – në nenin 59, ndërsa një dënim – mundësi e tillë e dënimit alternativ nuk është i paraparë as në Kodin penal të Shqipërisë dhe as në atë të Kosovës. Në takimet rajonale ku diskutohen këto çështje, do të ishte mirë të analizohej në veçanti kjo masë dhe të shihet se a do të mund të unifikohet apo të gjendej një

qasje e ngjashme që do të promovonte këtë masë alternative të dënimit, për raste-dënime të lehta apo shumë të lehta.

- Për burgun shtëpiak:

Burgu shtëpiak është i paraparë në Kodet penale të Republikës së Shqipërisë, në nenin 59/a dhe atë të Maqedonisë së Veriut, në nenin 59-a. Në Shqipëri është i paraparë si mundësi për dënimet deri në 2 vjet burgim, ose në se kjo periudhë është e mbetur nga vuajtja e dënimit, ndërsa në Maqedoninë e Veriut për dënime deri në 1 vjet me burgim ose me gjobë. Është interesant të përmendet fakti se kjo masë e dënimit alternativ nuk është i paraparë në Kodin penal të Republikës së Kosovës. Në nenin 79 përmendet arresti shtëpiak si mundësi e llogaritjes së paraburgimit.

- Për gjysmë lirinë:

Nga Tabela 1 mund të shihet se dënimi alternativ i gjysmë lirisë është i paraparë në mënyrë të drejtpërdrejtë si mundësi në Kodet penale të Republikës së Shqipërisë (neni 58) dhe atë të Kosovës (neni 58), ndërsa si e tillë nuk është paraparë në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Një masë e tillë e drejtpërdrejtë alternative që mundëson kombinimin e dënimit me atë me burg dhe me detyrim jashtë burgut, për kushtet të parapara, do të ishte mirë që të trajtohet edhe në Kodin penal në Maqedoni, si një mundësi shtesë e dënimit alternativ që tashmë është e etabluar në shtetet fqinje.

KAPITULLI II

1. Faktorët objektiv

Gjatë hulumtimit të akteve kriminale shpesh keqkuptohet personaliteti i kryerësit duke u krijuar përshtypja se veprimet kriminale rezultojnë nga vetitë e brendshme. Në fakt kjo nuk qëndron gjithmonë për shkak se vetitë e brendshme apo personaliteti ndikohet nga shumëllojshmëri faktorësh të natyrës objektive.

Nga faktorët e jashtëm, apo të ashtuquajtur objektiv do të shqyrtojmë fenomenet si: Gjendja ekonomike, Krizat, Depresionet ekonomike, Varfëria dhe Papunësia.

1.1 Gjendja ekonomike

Gjendja ekonomike, në fakt, paraqet një faktor më të gjerë që në tërësinë e tij përfshin disa faktorë: faktorët ekonomik-shoqëror, industrializimi, urbanizimi dhe kriminaliteti, migrimi i njerëzve dhe kriminaliteti i të huajve, faktorët idepolitik të kriminalitet.

1.1.1. Faktorët ekonomik-shoqërore

Zhvillimi i hovshëm industrial, të arriturat e mëdha teknike, zhvillimi i elektronikës dhe një varg transformimesh të mëdha që janë bërë në shoqëri, kanë ndikuar edhe në proceset e formimit të njeriut dhe personalitetit të tij. Këto të arritura dhe transformime të mëdha në një anë kanë kontribuar në krijimin e një mirëqenie dhe standardi të lartë, në anën tjetër, me miliona njerëz vuajnë nga uria, skamja, papunësia dhe sëmundjet e ndryshme. Të gjitha këto kanë ndikim të caktuar në veprimet dhe sjelljet kriminale. Në vijim do të trajtohet ndikimi i industrialimit, urbanizimit, krizave ekonomike, kundërthënieve dhe tronditjeve sociale e politike, varfërisë, papunësisë e dukurive tjera në paraqitjen e kriminalitetit (Latifi, 2004)¹⁵.

1.1.2. Industrializimi, urbanizimi dhe kriminaliteti

Me industrializim të shoqërisë nënkuptohet një proces i zhvillimit të hovshëm ekonomik e material, mirëpo, industrializimi dhe urbanizimi i shpejtuar, si dhe ndryshimet që kanë pasuar në vende të ndryshme, shpesh kanë pasur edhe efekte dhe ndikime negative dhe merret si faktorë kriminogjen për arsye se ka sjell lëvizjen, migrimin dhe grumbullimin e madh të popullsisë nëpër disa qendra dhe qytete të mëdha. Është paraqitur dukuria e alkoolizmit, narkomanisë, bixhozit, prostitucionit etj.

1.1.3. Migrimi i njerëzve dhe kriminaliteti i të huajve

Problemi i emigrimit dhe prania e të huajve, në shumë vende po shkakton kundërthënie dhe sjellje kriminale. autori gjerman thekson se një ndër arsyet e sjelljeve kriminale të huajve në gjermani, është edhe fakti i grumbullimit dhe vet izolimit të tyre në mjedise të veçanta, dhe

¹⁵ Latif Veseli, Politika Kriminale, Prishtinë, 2004, faqe 256.

përpjekja që ti ruajnë disa zakone dhe rregulla nga vendi prej të cilit kanë ardhur sepse ndihen të pasigurt, të frikësuar. Ndjenja e pasigurisë dhe urrejtja ndaj të huajve apo Ksenofobia janë gjendje që përherë i përcjellin të huajt për shumë arsye, pastaj, pengesat që paraqiten lidhur me punësimin dhe vendosjen e tyre, ndikon që ata për të siguruar kushtet e jetesës merren me aktivitete kriminale.

1.1.4. Faktorët ideopolitike të kriminalitetit

Përfshijnë një numër të madh shkaktarësh dhe rrethanash që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit në shoqëri (Halili, Kriminologjia, 2011)¹⁶. Të tillë janë: konfliktet politike, konfliktet kulturore, luftërat dhe rrethanat e luftës, shtëpi, literatura, televizioni, filmi, arsimimi, religjioni etj.

1.2. Krizat, depresionet ekonomike dhe kriminaliteti

Trajtohen si faktorët që kanë ndikim të dukshëm në sjelljet kriminale. Krizat ekonomike ndikojnë në paraqitjen e konflikteve dhe kundërthënive brenda një familje dhe në grupe të ndryshme shoqërore ku me këtë rast rriten disa forma të sjelljeve kriminale sic janë vjedhjet, mashtrimet, abuzimet, tregtia e palejuar, bixhozi, prostitucioni etj.

1.3. Varfëria dhe kriminaliteti

Është faktor objektiv i kriminalitetit i cili ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale Aristoteli ka theksuar se “varfëria është nëna e krimit, ndërsa begatia nëna e amoralitetit”

Ka mendime të cilat theksojnë se varfëria dhe skamja mund të ushtrojnë ndikim në sjelljet dhe qëndrimet e disa individëve të cilët janë të zhytur në veprime kriminale. Mirëpo, kriminaliteti i gjithmbarshëm në një shoqëri, në një shtet, nuk është rezultat vetëm i varfërisë dhe i mungesës së kushteve materiale, por shpeshherë është rezultat edhe i ndikimit dhe rrethanave e kushteve tjera. Këtë më së miri e vërteton kriminaliteti i jakës së bardhë dhe kriminaliteti i organizuar. Format më të shpeshta të sjelljeve kriminale të cilat kryhen për shkak

¹⁶ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, faqe 241.

të varfërisë dhe kushteve të vështira materiale janë vjedhjet e imta, grabitjet, mashtrimet, dhënia pas bredhjes, lëmshës, prostitucionit dhe alkoolizimit.

1.4. Papunësia dhe kriminaliteti

Është e ngjashme me dukurinë e varfërisë e cila ka të bëjë me pamundësinë e punësimit dhe këqyrjen në punë të njerëzve, e kjo sjell mungesën e mjeteve për ekzistencë. Kjo dukuri ndikon në gjendjen psikike dhe shpirtërore të individëve dhe familjeve të caktuara të cilët shpeshherë duke dashur të dalin nga kjo gjendje e vështirë fillojnë të merren me disa aktivitete dhe veprime të dëmshme sociale, p.sh. me prostitucion, bredhje, lëmshë, braktisje të familjes dhe të fëmijëve.

1.5. Kushtet e vështira të banimit dhe kriminaliteti

Gjithashtu zënë vend të rëndësishëm në trajtimet dhe kërkimet empirike të etiologjisë kriminale. Problemi i banimit e sidomos mungesa e zgjedhjes së çështjes së banimit adekuat është i lidhur me procesin e migrimit të popullsisë, me përqendrimin e saj nëpër qendra dhe qytete të mëdha e cila rezulton në ashpërsimin e raporteve në mes të qytetarëve dhe kundërthënie të ndryshme p.sh. në familjet me një numër të madh anëtarësh në ambiente shumë të ngushta dhe pa kushtet elementare për jetesë shpeshherë të miturit janë ata që detyrohen ta braktisin familjen dhe të kërkojnë zgjedhje të reja duke filluar të merren me veprime kriminale.

1.6. Profesionit-mjeshtri dhe kriminaliteti

Konsiderohet gjithashtu si faktorë që ndikon në paraqitjen e kriminalitetit. Disa autorë, si për shembull (Ehrlich, 1973)¹⁷ dhe (Lageson & Uggen, 2013)¹⁸ mendojnë se disa personave që u përkasin profesioneve të caktuara vet puna e tyre ua lehtëson kryerjen e disa formave të

¹⁷ Ehrlich, I. (1973). Participation in illegitimate activities: a theoretical and empirical investigation. *Journal of Political Economy*, 81 (3), 521–565.

¹⁸ Sarah Lageson and Christopher Uggen, *How Work Affects Crime—And Crime Affects Work—Over The Life Course*, *Handbook of Life-Course Criminology: 201 Emerging Trends and Directions for Future Research*, New York, 2013, 201-209.

kriminalitetit. Në praktikën e përditshme gjyqësore dhe nga ana e të dhënave statistikore kriminale shihet se punëtorët që punojnë në profesionin e kontabilistëve, llogaridhënësve, depozitave, furnizuesve etj., me shpesh paraqiten si abuzues, mashtrues, falsifikues të dokumentacioneve dhe librave financiare, pastaj abortimet ilegale, shërimet joadekuate, eksperimentet medicinale në të sëmurë etj.

2. Faktorët subjektiv

Kur flitet për këta faktorë zakonisht mendohet për individin, për personalitetin e njeriut në rastin konkret të njeriut delikuent. Vetitë biologjike dhe psikike shumë herë janë komponentë me rëndësi vendimtare në jetën e njeriut. Në Literaturën Kriminologjike faktorët subjektiv të sjelljes kriminale zakonisht ndahen në faktorë psikologjik-psikik dhe në faktorë biologjik (Halili, Kriminologjia, 2016).

Personaliteti i njeriut është i ndërtuar në bazë psikike dhe biologjike që janë dy komponentë me rëndësi për zhvillimin dhe formimin e tij si personalitet normal. Ekziston edhe komponenti tjetër apo baza sociale dhe familjare që janë si faktor objektiv. Faza psikike ka ndikim dhe reflektohet në sjelljet dhe veprimet e personalitetit të njeriut gjatë jetës së tij. Bota e tij e brendshme, bota psikike ka rëndësi të veçantë në shpjegimin e sjelljeve kriminale. Si veti dhe cilësi psikike që e formon dhe e karakterizon një individ.

2.1. Karakteri dhe kriminaliteti

Konsiderohet si veti e cilësi kryesore e një personaliteti. nocioni karakter d.m.th. personalitet ku paraqet vetëm një veti psikike të një individi e të cilat vulojnë tërë aktivitetin njerëzor. Si komponentë të karakterit konsiderohen vullneti, qëndrueshmëria, vendosmëria, siguria, guximi, besnikëria, stabiliteti etj. Me karakter duhet kuptuar sistemin e tipareve dhe vetive të personalitetit të cilat tregojnë si vepron individi karshi disa primeve dhe vlerave morale të shoqërisë së caktuar. Ai është produkt i edukatës në procesin e socializimit të njeriut ku rol dominues kanë familja, shkolla dhe ambienti social. Ndër kryesit e veprave penale dhe sjelljeve delikente, më së shpeshti ndeshemi me persona të cilët nuk i kanë virtytet dhe vetitë pozitive të karakterit. Si veti dhe tipare të karakterit përmendim nderin, ndërgjegjshmërinë,

vetëbesimin, ndershmërinë, vetkritikën, guximin, frikën etj. Është e domosdoshme që gjatë ndriçimit të çdo sjelljeje kriminale të individit dhe njihet karakteri i tij (Sahiti, 2007)¹⁹.

2.2. Temperamenti dhe kriminaliteti

Është një veti dhe cilësi me rëndësi psikike e individit e cila manifestohet me reagimin e tij ndaj ngacmimeve dhe ngjitjeve të ndryshme të jashtme. Ai nënkupton shpejtësinë dhe zgjatjen e reaksioneve të individit ndaj ngjarjeve dhe ngacmimeve, të ambientit i cili e rrethon në drejtim të caktuar. Janë të njohura klasifikimet e Aristotelit dhe Hipokratit. Më i njohur është ai i Hipokratit, i përshkruar nga (Merenda, 1987)²⁰, ku njerëzit ndahen në katër tipa themelorë të temperamentit, të shpjeguara në vazhdim.

2.2.1. Temperamenti kolerik

Manifestohet me ndjenja dhe emocione intensive, me vendosjen e lehtë për të ndërmarrë ndonjë aktivitet apo veprim që ky tip i personaliteti shqetësohet shpejtë me gjëra të imta dhe bie në konflikt me personat tjerë, këta tipa zemërohen e hidhërohen dhe këtë gjendje e manifestojnë gjatë dhe haptas, nuk janë stabil dhe shpejtë e ndërrojnë disponimin. Ky tip i temperamentit ndikon në paraqitjen e disa sjelljeve negative që i paraprijnë aktiviteteve devijante-kriminale.

2.2.2. Temperamenti sanguinik

Ky tip i personave reagon shpejtë me vrull mirëpo emocionet e tyre nuk janë të fuqishme dhe nuk zgjasin shumë, disponimi i tyre ndërron lehtë që nga zemërimi i madh kalon në gëzim dhe hare. Te ata vërehet një ngushtim i aftësisë së gjykimit dhe logjikimit në situata të caktuara dhe përcaktohen si persona gjaknxehtë. Këta persona shpeshherë kryejnë disa sjellje kriminale në afekt, në raste të cilat në literaturën e psikologjisë kriminale shpjegohen si gjendje psikike shpirtërore të veçanta.

¹⁹ Ejup Sahiti, Psikologjia gjyqësore, Prishtinë, 2007, faqe 176.

²⁰ Merenda, P. F. (1987). "Toward a Four-Factor Theory of Temperament and/or Personality". *Journal of Personality Assessment*. 51 (3): 367–374.

2.2.3. Temperamenti flegmatik

Paraqet tipin e personit i cili me sjelljet dhe qëndrimet e veta reagon në mënyrë të ngadalshme dhe rrallë shqetësohet dhe emocionet i ka të dobëta dhe vështirë manifestohen. Ky tip i personave nuk është i ndjeshëm ndaj ngacmimeve të jashtme, nuk ngutet, është i qetë dhe stabil prandaj edhe thuhet se këta persona veprimet e ndryshme delikuede i kryejnë me paramendim.

Për shkak të përparimit të shpejtë industrial dhe teknologjik dhe hapësirës të madhe midis të pasurve dhe të varfërve, bota është aq materialiste sa mund të ishte ndonjëherë. Ata që janë të pasur përbëjnë "elitat" ndërsa të varfërit shihen me sy të keq. Të detyruar nga rrethanat dhe nevoja, të varfërit shpesh i drejtohen kriminalitetit për të kapërcyer situatën e tyre të pafuqishme të shënuar nga sëmundje, analfabetizëm, uri, fatkeqësi dhe zemërim. Pikëpamja e parë përshkruan se marrëdhënia midis ekonomisë dhe krimit është e anasjelltë; incidenca e krimit është e ulët kur kushtet ekonomike janë të favorshme ndërsa në kohë depresioni ekonomik, niveli i krimit rritet. Ai më tej shtjelloi se në një ekonomi, inflacioni krijon falimentim dhe paaftësi paguese, dhe personat e prekur prej saj detyrohen të bëjnë një jetë anti-shoqërore dhe madje mund të përdorin kriminalitetin. Ai gjithashtu pohoi se varfëria është një kusht thelbësor i krimit sepse një person do të bënte gjithçka për të dalë nga gjendja e tij e mjerueshme ekonomike.

Nga ky vështrim i literaturës në lidhje me Faktorët e jashtëm dhe të brendshëm, mund të konkludojmë se:

- Faktorët e jashtëm paraqesin kushtet dhe rrethanat determinuese të sjelljes kriminale, ata ndikojnë në paraqitjen e aktiviteteve kriminale në shoqëri.
- Faktorët e jashtëm (objektiv) janë të llojllojshme dhe secila ka rëndësinë dhe rolin e vet në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Kemi disa ndarje të faktorëve të jashtëm (objektiv) e sidomos duke marrë parasysh të dhënat statistikore mbi kriminalitetin.
- Gjatë hulumtimit tim faktorët e jashtëm (objektiv) janë ndër faktorët që në shumicën e

rasteve drejtpërdrejt ndikojnë në aktivitete kriminale në shoqëri, si për shembull nga gjendja ekonomike e dobët personat janë më të prirur për të kryer vepra si: Vjedhje të lehtë, vjedhje të rëndë, etj.

- Faktorët e brendshëm (subjektiv) kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit, rolin dhe rëndësinë e jetës në lidhje me sjelljet dhe veprimet kriminale.

- Ndikimet e faktorëve të brendshëm tregojnë se ekzistojnë vetitë biologjike dhe psikike dhe tregojnë se këta veti janë me rëndësi vendimtare në jetën e njeriut.

- Varësisht se si janë të zhvilluara dhe si funksionojnë ato kanë ndikim në sjelljen dhe qëndrimet e njerëzve. Ato varen nga vetitë psikike dhe biologjike. Nëse ata persona nuk i kanë këta veti dhe nëse sjellja është ndërtuar në mënyrë të rregullt atëherë personaliteti i njeriut është rezistent ndaj ngacmimeve dhe ndikimeve që vijnë nga jashtë.

KAPTIULLI III

1. Masat alternative në Kodin Penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut (KPMV)

Masat alternative në të drejtën tonë penale paraqesin dënimin me burg dhe vërejtja gjyqësore të pozicionuara si sanksione dominonte.

KPMV (në tekstin i referohemi këtij burimi)²¹ përcakton qëllimin e veçantë të masave alternative sipas përgjegjësisë penale ndaj kryerësit të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta

²¹ Kodi Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 37/96). Ligjet për Ndryshimet në Kodin Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 80/99, 4/02, 43/03, 19/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013). Teksti i spastruar i shpallur nga Prokuroria publike e Republikës së Maqedonisë (<http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/законик-пречистен-текст.pdf>).

kur ajo nuk është e patjetërsueshme për mbrojtjen penalo-juridike dhe kur mund të pritët se qëllimi i dënimit mund të realizohet me paralajmërim me kërcënim për dënim (lirim me kusht), vetëm paralajmërim (vërejtje gjyqësore), ose me masa të ndihmës dhe mbikëqyrjes (sjellja e kryerësit në liri). Qëllimi i këtillë qartë i distancon masat alternative prej dënimeve (Kodi penal i Maqedonisë së Veriut). Për dallim nga dënimi, i cili është sanksion retributiv-preventiv, masat alternative janë sanksione preventive të të cilat elementi retributiv është i nxitur dhe i vendosur në funksion të kërcënimit me dënim që e forcon veprimin special-preventiv të tyre.

2. Llojet e masave alternative

Me ndryshimet në KPMV të vitit 2004 është vendosur sistemi i rrumbullakosur i masave alternative i cili përmban: dënimin me kusht, dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, ndërprerje me kusht e procedurës penale, puna në dobi të përgjithshme, vërejtja gjyqësore, burgu shtëpiak.

Për të analizuar nivelin e shqiptimit të masave alternative në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si një ndër objektivat kryesor të punimit, do të bëjmë krahasimin me dënimet e përgjithshme për persona në moshë madhore, të shqiptuara në Maqedoni për periudhën mes viteve 2008 – 2018. Ky raport mes të dënuarve me dënimet e përgjithshme dhe atyre me masa alternative në nivel republikan është paraqitur në Tabelën 2, me të dhëna nga Enti shtetëror statistikor (Enti shtetëror i statistikës së Republikës të Maqedonisë së Veriut, 2020)²².

Tabela 2

Raporti i të dënuarve dhe masave alternative në RMV
në periudhën 2008-2017

Viti	Të dënuar	Masa alternative	Përqindja
2008	9503	5059	53%
2009	9801	4878	50%
2010	9169	4283	47%


²² Enti shtetëror i statistikës, <http://www.stat.gov.mk/>

2011	9810	4394	45%
2012	9042	3565	39%
2013	9539	3914	41%
2014	11683	5417	46%
2015	10312	4464	43%
2016	8172	4332	53%
2017	6273	3519	56%
2018	5857	3454	59%
Mesatarja	8966	4298	48%

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Në tabelën 2 është llogaritur edhe përqindja mesatare e dënimeve me masa alternative kundrejt dënimeve të përgjithshme, ku rezulton se në nivel republikan, 48% (afër gjysma e rasteve ~ 50%) e rasteve janë dënuar me masa alternative. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të trendit të këtij raporti në vite, të dhënat tabelore janë të paraqitura në formën grafike dhe të paraqitura në Figurën 2.

Figura 2.



Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Siç mund të shihet edhe në grafikun e paraqitur në Figurën 2, trendi i raportit të shqiptimit të masave alternative në krahasim me dënimet e përgjithshme është ruajtur në një mesatare rreth 50% në periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2018. Mund të shihet një ulje e vogël e këtij raporti në vitet 2012, 2013, por që në përgjithësi trendi është ruajtur.

Megjithëse teoria e masave alternative është zhvilluar shumë kohëve të fundit, praktika e zbatimit të tyre në sistemin gjyqësor në Republikë varion në masë të madhe. Për të shpjeguar zbatimin e masave alternative sipas llojit të masës, kemi analizuar të gjitha llojet e dënimeve me masa alternative në nivel republikan, për periudhën e viteve 2008-2017, nga të dhëna të mara në Entin statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Këto të dhëna janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 3

Dënimet alternative në RMV në periudhën 2008-2018

Viti	Dënim me kusht	Me gjobë	Nënmbikëqyrje mbrojtëse	Ndërprerja e procedurës me kusht	Punanë dobitë përgjithshme	Vërejtja gjyqësore	Burgu shtëpiak
2008	4266	611	0	0	0	182	0
2009	4238	460	0	0	0	180	0
2010	3753	385	0	0	0	145	0
2011	4052	189	0	0	0	153	0
2012	3319	114	0	0	2	130	0
2013	3667	137	0	0	0	110	0
2014	5029	314	0	0	0	74	0
2015	4358	43	0	0	0	63	0
2016	4179	29	74	0	0	61	0
2017	3343	130	0	0	0	46	0
2018	3307	108	0	0	0	39	0
Gjithsej	92%	5%	0%	0%	0%	3%	0%

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Nga kjo tabelë e dënimeve alternative në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2008-2018, për fat të keq, mund të shihet se shumica dërmuese e dënimeve alternative janë ato të dënimit me kusht (92%), pastaj në një masë të vogël ato nga dënimi me gjobë (5%) dhe vërejtja gjyqësore (3%). Llojet tjera të dënimeve alternative, si ajo e dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, ndërprerja e procedurës me kusht, puna në dobi të përgjithshme dhe burgu shtëpiak, thuajse nuk janë të përfaqësuara, ose jashtëzakonisht pak të përfaqësuara. Këto janë të dhënat zyrtare nga Enti statistikor i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe fitohet përshtypja se ndoshta mënyra e raportimit nga Gjykatat themelore nuk është më e sakta, siç e kemi vërejtur në rastin e Gjykatës themelore në Dibër, që do ta shtjellojmë më vonë.

3. Dënimi me kusht

3.1. Nocioni dhe sistemi i dënimit me kusht

Kuptimi themelor i dënimit me kusht përbëhet nga pezullimi i shqiptimit ose kryerja e dënimit të cilën varet nga sjellja e ardhshme e kryerësit: nëse përmirësohet dhe nuk kryen veprë të re penale në interval kohor të caktuar të quajtur koha e kontrollit, dënimi nuk do të shqiptohet e as do të ekzekutohet (Kambovski, E drejta penale - pjesa e përgjithshme, 2007)²³.

Por nëse në këtë periudhë kryen veprë të re penal, në kushte të caktuara mundet të shqiptohet dhe të kryhet edhe dënimi, zbatimi i së cilës është pezulluar. Mundësia për efektuimin e dënimit është korrektor plotësues i sjelljes së kryerësit që duhet të ndikojë në të dhe të përmbahet nga kryerja e e veprës së re. Për këtë, thelbi i dënimit me kusht si alternativë e dënimit është koncentruar mbi paralajmërimin me kërcënim për dënim efektiv. Ajo nuk është paralajmërim i thjeshtë siç është përmbajtja e vërejtjes gjyqësore, por përmban një element potencial retributiv i cili mbetet në kufijtë e mundësisë, por derisa i dënuari i përmbahet kushtit me të cilin është pezulluar dënimi efektiv.

Në legjislacionet bashkëkohore penale janë zhvilluar dy sisteme të dënimit me kusht: sistemi anglo-saksonik i probacionit dhe sistemit kontinental i dënimit me kusht.

3.2. Dënimi me kusht sipas KPMV

Në të drejtën penale të RM është i pranuar sistemi i përzier: Në nenet 49 dhe 55 të KPMV si masa të veçanta alternative i parasheh edhe dënimin me kusht dhe dënimin me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse. Në raport me dënimin me kusht, është i pranuar sistemi kontinental. Sipas nenit 49 të KPMV, me dënimin me kusht, gjykata ia përcakton dënimin kryerësit për veprën e kryer dhe njëkohësisht përcakton se ai dënimi nuk do të kryhet nëse autori për kohën të cilën do t'ja caktojë gjykata, e cila nuk mund të jetë më e shkurt se një vit dhe më e gjatë se 5 vite, nëse nuk kryen veprë të lehtë penale.

Kushti themelor për të cilin pezullohet kryerja e dënimit të përcaktuar është d.m.th kryerësi të mos kryej veprë të re në kohën e kontrollit. Gjukata, sipas nenit 50 të KPMV,

²³ Vlado Kambovski, E drejta penale - pjesa e përgjithshme, Shkup, 2007, faqe 532.

paragrafi 2, mund të përcaktojë edhe kushte plotësuese që mund të përbëhen në obligimin e të dënuarit në afat të caktuar ta kthej të mirën pasurore të fituar vepër penale ta kompensojë dëmin që e ka nxitur me vepër penale ose ti kryej obligimet me dispozitat penalo-juridike.

4. Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse

Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse është variant i dënimit me kusht. Pranimi i saj ishte i arsyetuar me udhëzimet e përvojave pozitive të zbatimit të probacionit në legjistratura tjera. Gjasa e risocializimit të kryerësve, posaçërisht shkelësve të parë janë më të mëdha përveç suspendimit të dënimit me kusht ndërmerret edhe aksion pozitiv në formë të ndihmës.

Kushtet ligjore sipas KPM

Me kushtet e përgjithshme ligjore për shqiptimin e dënimit me kusht gjykata²³ mund të caktojë mbikëqyrje mbrojtëse kur rrethanat që kanë të bëjnë me personalitetin e autorit ose rrethin në të cilin jeton e bëjnë të arsyeshme pritjen, se qëllimi i dënimit me kusht do të arrihet nëse përcaktohen masat ndihmëse, kujdesi, mbikëqyrja ose mbrojtja.

Kohëzgjatja dhe përmbajtja e mbikëqyrjes mbrojtëse.

E cakton gjykata në kohën e caktuar, në kohën e kontrollit, kjo do të thotë se gjykata shqipton dënimin me kusht, kjo e cakton kohën për kontroll se nuk mund të jetë më e shkurtër se një dhe nuk mund të jetë më e gjatë se pesë vjet (Halili, Penologjia, 2014)²⁴.

Organet kompetente për zbatimin e mbikëqyrjes mbrojtëse

Këtë e zbaton organi social, i cili e realizon jep ndihmë, përkujdesje dhe mbrojtje në plotësimin e obligimeve nga ana e të dënuarit. Me organ social nënkuptohet organet për punë sociale në komunë, qendra për punë sociale dhe organet e tjera të cilat janë të formuara me ligj për të kryer veprimtari sociale.

²⁴ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2014, faqe 244.

4.1. Ndërprerja me kusht e procedurës penale

Kjo masë alternative në legjislaturën tonë është e futur me ndryshimet e vitit 2004, në nenin 55 të KPMV. Ndërprerja me kusht e procedurës penale është alternativë gjyqësore e zhvillimit të procedurës penale.

Sipas kësaj nuk bëhet fjalë për variant të dënimit me kusht, por në variant të procedurës penale me të cilin i ikim shqiptimit i aktgjykimit. Me ndërprerjen me kusht të procedurës penale si masë penalo-juridike ndërlidhet edhe parimi relativisht i gjerë në LPP, sipas të cilit në raste të tilla prokurori publik mund të vendos dhe aspak të mos ngre procedurë penale.

Kushtet për ndërprerje

Gjykata mund të vendos me kusht ta ndërpresë procedurën penale nëse ka të bëj me veprën penale për të cilën është l paraparë dënimi me të holla ose dënim me burg deri në një vjet, me kusht që kryerësi në afatin që zgjat ndërprerja, të mos kryejë vepër të re penale.

Vendim të tillë gjykata sjell pas hetimeve të bëra ndaj të pandehurit, dëgjimi dhe pëlqimi i të dëmtuarit (neni 507 i LPP)²⁵. Me vendim gjyqësor procedura mund të ndërpritet në afat më së shumti prej një viti, afat i cili nuk llogaritet në afatin e parashkrimit të ndjekjes penale.

Ndërprerja me kusht e procedurës penale ka karakter të faljes gjyqësore që kryerësi e fiton për sjelljen e tij pas kryerjes së veprës-mënjanimi i pasojave të dëmshme të veprës dhe mos kryerja e veprës së re në afatin e kontrollit.

Procedura ndërpritet me vendim që pas hyrjes së tij në fuqi ka karakter resiudicata.

²⁵ Закон за Кривичната Постапка, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 150, 18.11.2010.

5. Puna në dobi të përgjithshme

5.1. Nocioni dhe natyra juridike

Puna në dobi të përgjithshme është masë alternative që përbëhet në punë të detyrueshme të papaguar, numër i përcaktuar i orëve të lira të kryerësit në dobi të përgjithshme.

Në legjislaturën tonë penale kjo masë është futur me ndryshimet në KPMV të vitit 2004, në nenin 58-6.

Me këtë nga njëra anë është theksuar natyra preventive dhe risocializuese e këtij sanksioni, kurse nga ana tjetër involvimi i bashkësisë në masat e ndihmës dhe mbikëqyrjes së kryerësit, që krijon supozime reale për shmangien e dënimeve të vogla me burg.

5.2. Kushtet ligjore për shqiptim sipas KPM

Masat për punë në dobi të përgjithshme mund të shqiptohet për vepër penale për të cilën është i paraparë dënim me të holla ose dënim me burg deri në tre vjet, në pëlqim me kryerësin, nëse vepra është në rrethana lehtësuese dhe kryerësi më parë nuk ka qenë i dënuar.

Masat shqiptohen në kohëzgjatje prej 40 deri 240 orë që i dënuari ti punojë pa shpërblim nga ana e organeve të shtetit, ndërmarrjet publike, organizatat humanitare, gjatë kohës të festave shtetërore, punë gjatë të shtunave dhe të dielave dhe jo më pakë se pesë orë në javë në periudhë prej 12 muajve (Zejneli & Sahiti, 2017)²⁶.

6. Vërejtja gjyqësore

6.1. Nocioni dhe natyra juridike

Vërejtja gjyqësore përbëhet zakonisht në paralajmërimin e të dënuarit. Vendimi për vërejtjen gjyqësore përmban konstatim për fajin dhe mbi këtë qortimi që mbetet në rrafshin e mos miratimit të shqiptuar publik, qortimi për veprën e kryer që e potencon karakterin preventive të sanksionit.

²⁶ Ismail Zejneli, Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017, faqe 310.

Nga aspekti politiko-kriminal vërejtja gjyqësore është alternativë për dënimin e rezervuar për vepra më të lehta.

KPM vërejtja gjyqësore është e sistematizuar në regjistrin e masave alternative. Sipas kësaj, bëhet fjalë për masë të posaçme specialo-preventive që e realizon veprimin e vet nëpërmjet qortimit moral mosmiratimit publik për veprën e kryer.

6.2. Kushtet ligjore për shqiptim

Sipas KPM qëllimi i vërejtjes gjyqësore është që kundër kryerësit me përgjegjësi penale të mos zbatohet dënim për vepra të lehta kur kjo nuk është e patjetërsueshme për shkak të mbrojtjes penalo-juridike dhe kur mund të pritët se qëllimi i dënimit mund të realizohet vetëm me paralajmërim. E para, vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet me rregull për vepra për të cilat është i paraparë burg deri në një vit, e dyta, vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për vepra të cilat është e paraparë dënim me burg deri në 3 vite, të parapara në nenin 59 të KPMV.

7. Burgu shtëpiak

7.1. Nocioni dhe natyra juridike

Burgu shtëpiak është modalitet i vuajtjes së dënimit me burg: i dënuari të cilit në kushte të caktuara ligjore i është shqiptuar dënim me burg dhe të njëjtën e vuan në shtëpi.

Në legjislacionet bashkëkohore kjo alternativë kryesisht depërton në dy forma: si burg shtëpiak i thjeshtë dhe burg shtëpiak me kontroll elektronike. Burgu shtëpiak i rëndomtë ka ndalesë të për tërë ditën, kohën e caktuar gjatë ditën ose gjatë natës, sipas nenit 59-a të KPMV. Burgu shtëpiak me ndjeje elektronike, përveç ndalesës themelore për lëshim të shtëpisë kyç edhe ndjekje permanente të lëvizjes të të dënuarit në kohën e përcaktuar nga gjykata në shtëpi ose jashtë shtëpisë, me mjete special elektronike që zakonisht e bën policia.

Ekzistojnë mbikëqyrje pasive dhe aktive elektronike: aparati për mbikëqyrje që reagon me sinjal të dënuar me lidhje elektronike, ndërsa e dyta me bylizik në dorë edhe ajo reagon me sinjal.

7.2. Kushtet ligjore të KPMV

KPMV e kufizon zbatimin e burgut shtëpiak te veprat më të lehta dhe dënimet afatshkurta të burgut të kategorisë të posaçme të të dënuarve për të cilën do të ishte joadekuate vuajtja në institucionet e burgut. Sipas kushteve ligjore nëse kryerësi i veprës penale për të cilin është i paraparë dënim me të holla ose dënim deri në një vjet, është i vjetër dhe i pamundur, i sëmurë ose grua shtatzëne, gjykata mund t'i shqiptojë dënim me burg dhe njëkohësisht të vendos me pëlqimin e tij që dënimin ta vuan në shtëpi.

KAPITULLI IV

1. Shqiptimi i dënimeve alternative në gjykatën themelore në Dibër

Në Gjykatën themelore në Dibër, shqiptimi i dënimeve alternative është një praktikë që zbatohet në shumicën e dënimeve dhe që përkon me Hipotezën nr. 1. Për të vërtetuar këtë hipotezë, ne kemi analizuar raportin e dënimeve me masa alternative të shqiptuara në Gjykatën themelore në Dibër, për periudhën 2008-2018, në krahasim me numrin e dënimeve të përgjithshme. Rezultatet për vërtetimin e Hipotezës 1 janë paraqitur në Tabelën 4.

Tabela 4

Krahasimi i dënimeve alternative në RMV dhe në Gjykatën themelore në Dibër për periudhën
2008-2018

Viti	Të dënuar	Masa alternative	% Dibër
2008	53	32	60%
2009	53	22	42%


2010	43	35	81%
2011	70	40	57%
2012	32	22	69%
2013	133	51	38%
2014	141	84	60%
2015	90	52	58%
2016	69	48	70%
2017	40	29	73%
2018	52	39	75%
Gjithsej:	776	454	62%

Burimi: Enti shtetëror për statistikë

Nga tabela mund të shihet se përfaqësimi i dënimeve të shqiptuara me kusht në raport me dënimet e përgjithshme është në nivelin 62% në periudhën prej 2008-2018. Kjo vërteton se dënimi alternativ përdoret në masë të konsiderueshme në Gjykatën themelore në Dibër.

Për të analizuar trendin e dënimeve me masa alternative të shqiptuara në Gjykatën themelore në Dibër, do të paraqesim mënyrën grafike për periudhën mes viteve 2008-2018, të paraqitur në Figurën 3.

Figura 3.



Burimi: Enti shtetëror për statistikë

Siç edhe mund të shihet nga grafikoni në Figurën 3, në tre vitet e fundit të studimit tonë vërehet një rritje graduale e përqindjes së dënimeve të shqiptuara me masa alternative në krahasim me dënimet e përgjithshme për moshat madhore.

Për të bërë edhe sintezën e kësaj analize, do të bëjmë krahasimin e shqiptimit të dënimit alternativ në raport me dënimin e përgjithshëm në nivel Republikan me atë të Gjykatës themelore në Dibër. Kjo sintezë është paraqitur në Tabelën 5.

Tabela 5

Krahasimi i dënimeve alternative në RMV dhe në Gjykatën themelore në Dibër për periudhën 2008-2018


Viti	Të dënuar	Masa alternative	% RMV	% Dibër	Të dënuar	Masa alternative
2008	9503	5059	53%	60%	53	32
2009	9801	4878	50%	42%	53	22

2010	9169	4283	47%	81%	43	35
2011	9810	4394	45%	57%	70	40
2012	9042	3565	39%	69%	32	22
2013	9539	3914	41%	53%	133	71
2014	11683	5417	46%	37%	141	52
2015	10312	4464	43%	58%	90	52
2016	8172	4332	53%	70%	69	48
2017	6273	3519	56%	73%	40	29
2018	5857	3454	59%	75%	52	39
Gjithsej:	99161	47279	48%	61%	776	441

Burimi: Enti shtetëror për statistikë

Nga Tabela 3 qartë shihet se në Gjykatën themelore në Dibër përqindja e masave alternative është më e lartë se ajo në nivelin Republikan. Pra, mund të konstatojmë, se në Gjykatën themelore në Dibër shqiptimi i masave alternative është në nivel të konsiderueshëm. Për të na ndihmuar që të kemi një pasqyrë më të qartë të trendit të këtij krahasimi, në Figurën 4 kemi paraqitur grafikun e trendit të krahasimit të raportit mes dënimit alternativ me atë të përgjithshëm në Gjykatën themelore në Dibër dhe atë të nivelit Republikan.

Figura 4.



Burimi: Enti shtetëror për statistikë

Nga Figura 4, përveç në vitin 2009 dhe atë 2013, në të gjithë vitet tjera – periudhën tjetër, vërehet se në Gjykatën themelore në Dibër, dënimi me masa alternative është në nivel më të lartë se niveli republikan i shqiptimit të këtij lloji të dënimit. Gjithashtu, mund të vërehet edhe trendi rritës në trevjeçarin e fundi të analizës, të shqiptimit të dënimeve alternative, që mund të konstatohet si trend pozitiv në Gjykatën themelore në Dibër.

2. Raste studimore-hulumtuese

Për të vërtetuar Hipotezën nr.2, kemi përdorur metodën e shqyrtimit të rasteve të studimit. Në këtë hulumtim kemi analizuar tetë raste studimi të shqiptimit të dënimeve me masa alternative. Rastet e studimit janë analizuar për nga aspekti i llojit të veprës penale, argumentimi për shqiptimin e masës alternative, lloji i masës alternative si dhe arsyeshmëria dhe obligimet plotësuese eventuale, që janë pjesë e hipotezës.

Për të analizuar rastin e studimit kemi përdorur një strukturë unike të analizës. Për çdo rast studimi kemi analizuar llojin e veprës penale dhe kategorizimin e tyre sipas kodit penal, dënimi i shqiptuar për nga aspekti i natyrës së masës alternative, detajet e masës së shqiptuar si dhe arsyetimi i vendimit.

Rasti i studimit nr. 1

Lloji i veprës penale: Vjedhja e sendit të huaj - mjet motorik

Dënimi sipas kodit penal: Neni 242, paragrafi 2, alineja 1 nga Kodi penal i RMV

Baza juridike e dënimit alternativ: Neni 48, 48-a, 49 dhe 50 i Kodit penal të RMV

Lloji i dënimit alternativ: Burg me kusht

Masa e dënimit të shqiptuar: Deri në 3 muaj

Arsyetimi për shqiptimin e dënimit: Arsyetimi është bazuar në nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 të Kodit penal të RMV dhe nenet 15, 102, 105, 114, 381, 404, dhe 481 të Ligjit për procedurë penale (LPP).

Rasti i studimit nr. 2

Lloji i veprës penale: Kërcënim me mjet të rëndë

Dënimi sipas kodit penal: Neni 133 nga Kodi penal i RMV dhe neni 497 i ligjit për procedurë penale

Baza juridike e dënimit alternativ: Neni 32, 33, 39, 48, 48a dhe 50 i Kodit penal të RMV

Lloji i dënimit alternativ: Burg me kusht

Masa e dënimit të shqiptuar: Deri në 3 muaj

Arsyetimi për shqiptimin e dënimit: Arsyetimi është bazuar në nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 të Kodit penal të RMV dhe nenet 15, 102, 105, 114, 381, 404, dhe 481 të Ligjit për procedurë penale (LPP).

Rasti i studimit nr. 3

Lloji i veprës penale: Falsifikimi i dokumentit zyrtar

Dënimi sipas kodit penal: Neni 361, paragrafi 1, alineja 3 nga Kodi penal i RMV

Baza juridike e dënimit alternativ: Neni 48, 48-a, 49 dhe 50 i Kodit penal të RMV

Lloji i dënimit alternativ:Brug me kusht

Masa e dënimit të shqiptuar: Deri në 3 muaj

Arsyetimi për shqiptimin e dënimit: Arsyetimi është bazuar në nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 të Kodit penal të RMV dhe nenet 15, 102, 105, 114, 381, 404, dhe 481 të Ligjit për procedurë penale (LPP).

Rasti i studimit nr. 4

Lloji i veprës penale: Shkelje e sigurisë personale

Dënimi sipas kodit penal: Neni 244, paragrafi 2, alineja 1 nga Kodi penal i RMV

Baza juridike e dënimit alternativ: Neni 48, 48-a, 49 dhe 50 i Kodit penal të RMV

Lloji i dënimit alternativ:Burg me kusht

Masa e dënimit të shqiptuar: Deri në 3 muaj

Arsyetimi për shqiptimin e dënimit: Arsyetimi është bazuar në nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 të Kodit penal të RMV dhe nenet 15, 102, 105, 114, 381, 404, dhe 481 të Ligjit për procedurë penale (LPP).

Rasti i studimit nr. 5

Lloji i veprës penale: Lëndime trupore

Dënimi sipas kodit penal: Neni 130, paragrafi 1, alineja 3 nga Kodi penal i RMV

Baza juridike e dënimit alternativ: Neni 48, 48-a, 49 dhe 50 i Kodit penal të RMV

Lloji i dënimit alternativ:Burg me kusht

Masa e dënimit të shqiptuar: Deri në 3 muaj

Arsyetimi për shqiptimin e dënimit: Arsyetimi është bazuar në nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 të Kodit penal të RMV dhe nenet 15, 102, 105, 114, 381, 404, dhe 481 të Ligjit për procedurë penale (LPP).

Rasti i studimit nr. 6

Lloji i veprës penale: Vjedhje e rëndë

Dënimi sipas kodit penal: Neni 236, paragrafi 1, alineja 3 nga Kodi penal i RMV

Baza juridike e dënimit alternativ: Neni 48, 48-a, 49 dhe 50 i Kodit penal të RMV

Lloji i dënimit alternativ: Burg me kusht

Masa e dënimit të shqiptuar: Deri në 3 muaj

Arsyetimi për shqiptimin e dënimit: Arsyetimi është bazuar në nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 të Kodit penal të RMV dhe nenet 15, 102, 105, 114, 381, 404, dhe 481 të Ligjit për procedurë penale (LPP).

Rasti i studimit nr. 7

Lloji i veprës penale: Paraqitja e padisë së rrejshme

Dënimi sipas kodit penal: Neni 366, paragrafi 1, alineja 3 nga Kodi penal i RMV

Baza juridike e dënimit alternativ: Neni 48, 48-a, 49 dhe 50 i Kodit penal të RMV

Lloji i dënimit alternativ: Burg me kusht

Masa e dënimit të shqiptuar: Deri në 3 muaj

Arsyetimi për shqiptimin e dënimit: Arsyetimi është bazuar në nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 të Kodit penal të RMV dhe nenet 15, 102, 105, 114, 381, 404, dhe 481 të Ligjit për procedurë penale (LPP).

Rasti i studimit nr. 8

Lloji i veprës penale: Rrezikimi i rëndë në trafikun rrugor

Dënimi sipas kodit penal: Neni 297, paragrafi 3, alineja 1 nga Kodi penal i RMV

Baza juridike e dënimit alternativ: Neni 48, 48-a, 49 dhe 50 i Kodit penal të RMV

Lloji i dënimit alternativ: Burg me kusht

Masa e dënimit të shqiptuar: Deri në 3 muaj

Arsyetimi për shqiptimin e dënimit: Arsyetimi është bazuar në nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 të Kodit penal të RMV dhe nenet 15, 102, 105, 114, 381, 404, dhe 481 të Ligjit për procedurë penale (LPP).

Rasti i studimit nr. 9

Lloji i veprës penale: Vepër penale për vjedhje

Dënimi sipas kodit penal: Neni 288, paragrafi 5, alineja 1 nga Kodi penal i RMV

Baza juridike e dënimit alternativ: Neni 48, 48-a, 49 dhe 50 i Kodit penal të RMV

Lloji i dënimit alternativ: Dënim me gjobë

Masa e dënimit të shqiptuar: 100.000.00 den

Arsyetimi për shqiptimin e dënimit: Arsyetimi është bazuar në nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 të Kodit penal të RMV dhe nenet 15, 102, 105, 114, 381, 404, dhe 481 të Ligjit për procedurë penale (LPP).

Rasti i studimit nr. 10

Lloji i veprës penale: Kanosje për sigurime të policit në stacionin policor

Dënimi sipas kodit penal: Neni 144, paragrafi 3, alineja 1 nga Kodi penal i RMV

Baza juridike e dënimit alternativ: Neni 48, 48-a, 49 dhe 50 i Kodit penal të RMV

Lloji i dënimit alternativ: Dënim me gjobë

Masa e dënimit të shqiptuar: 30.000.00den

Arsyetimi për shqiptimin e dënimit: Arsyetimi është bazuar në nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35, 39, 48, 48-a, 49 dhe 50 të Kodit penal të RMV dhe nenet 15, 102, 105, 114, 381, 404, dhe 481 të Ligjit për procedurë penale (LPP).

Këto raste të studimit janë të reflektuara në pasqyrat e mëposhtme.

3. Caktimi i dënimit

Për të dhënë një vlerësim për dënimet e caktuara, përveç rasteve të studimit, kemi zhvilluar edhe një analizë të përimtësuar krahasimore të llojit të dënimeve alternative të shqiptuara në Gjykatën themelore të Dibrës dhe në Gjykatat themelore të disa qyteteve në pjesën perëndimore dhe qendrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe atë të Gjykatave themelore të Resnjës, Strugës, Ohrit dhe Manastirit. Të dhënat për Gjykatat themelore të këtyre qyteteve janë mare drejtpërdrejtë nga Enti statistikor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa për komunën e Dibrës janë marrë drejtpërdrejtë nga Arkiva e gjyqit, sepse në Entin statistikor nuk ishin të pasqyruara të dhënat për dënimet alternative. Ky është një problem sistemor, që do duhet të përmirësohet për të rritur besimin në të dhënat e institucioneve dhe që tejkalon qëllimin e kësaj teze.

Të dhënat janë pasqyruar në tabela përkatëse, të ndara për çdo vit veçmas, duke filluar nga vitit 2008 deri në vitin 2017 (për shkak se mungojnë të dhënat e përditësuara për llojet e masave alternative sipas Gjykatave themelore për vitin 2018), të paraqitura në Tabelat 6 – a, b, c, ç, d, dh, e, ë, f, g.

Tabela 6a.

Krahasimi i dënimeve alternative sipas disa gjykatave themelore në vitin 2008

Gjykata themelore	Të dënuar	Masa alternative	Me kusht	Me gjobë	Nën mbikëqyrje mbrojtëse	Ndërprerja e procedurës me kusht	Puna në dobi të përgjithshme	Vërejtja gjyqësore	Burgu shtëpiak
Dibër	53	32	31	0	0	0	0	1	0
Resnjë	48	38	20	0	0	0	0	18	0
Strugë	224	84	64	16	0	0	0	4	0
Ohër	194	83	64	15	0	0	0	4	0
Manastir	464	353	311	36	0	0	0	20	0

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Tabela 6b.

Krahasimi i dënimeve alternative sipas disa gjykatave themelore në vitin 2009

Gjykata themelore	Të dënuar	Masa alternative	Me kusht	Me gjobë	Nën mbikëqyrje mbrojtëse	Ndërprerja e procedurës me kusht	Puna në dobi të përgjithshme	Vërejtja gjyqësore	Burgu shtëpiak
Dibër	53	22	22	0	0	0	0	0	0
Resnjë	41	39	25	0	0	0	0	14	0
Strugë	173	45	42	3	0	0	0	0	0
Ohër	449	189	134	38	0	0	0	17	0
Manastir	517	334	319	10	0	0	0	5	0

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Tabela 6c.

Krahasimi i dënimeve alternative sipas disa gjykatave themelore në vitin 2010

Gjykata themelore	Te dënuar	Masa alternative	Me kusht	Me gjobë	Nën mbikëqyrje mbrojtëse	Ndërprerja e 46procedurës me kusht	Puna në dobi të përgjithshme	Vërejtja gjyqësore	Burgu shtëpiak
-------------------	-----------	------------------	----------	----------	--------------------------	------------------------------------	------------------------------	--------------------	----------------

Dibër	43	35	29	6	0	0	0	0	0
